

Pyetje dhe përgjigje gjatë takimit informues të mbajtur në kuadër të projektit Green-AL

Pyetje dhe përgjigje mbi komponentin teknik

Pyetje

A mund të aplikojë Organizata që unë përfaqësoj në grantet e Iniciativës dhe Partneritetit nëse nuk ka në Statutin e saj (fokusin) adresimin e çështjeve mjedisore?

Përgjigje

Nëse një Organizatë nuk ka të përcaktuar qartë në Statutin e saj adresimin/zgjidhjen e çështjeve mjedisore, atëherë kjo Organizatë nuk mund të aplikojë në grantet e Iniciativës dhe të jetë aplikanti Udhëheqës në grantet e Partneritetit. Por, Organizatat të cilat nuk kanë në fokusin e tyre zgjidhjen apo ngritjen e çështjeve mjedisore mund të bëhen pjesë e një partneriteti ku Udhëheqësi i këtij partneriteti ka në fokus çështjet mjedisore e bashkarisht të aplikojnë tek grantet e Partneritetit.

Pyetje

Çfarë nënkupton projekti Green-AL me eksperiencë 1 vjeçare?

Përgjigje

Me eksperiencë 1 vjeçare projekti Green-AL nënkupton, se çdo Organizatë mjedisore e cila kërkon të aplikojë për grante të Iniciativës duhet të përmbushë kriterin administrativ referuar legjislacionit Shqiptar në fuqi për Regjistrimin e OJF-ve dhe organizmave të ngjashme me to (<https://www.tatime.gov.al/c/5/77/86/regjistrimi>), të kenë status aktiv dhe t'a mbështesin atë me dokumentet e kërkuara në Udhëzues.

Pyetje

A ka sistem pikëzimi procesi i vlerësimit dhe a mund t'i jepet prioritet një projekti apo ideje inovative në raport me kriterin e eksperiencës?

Përgjigje

Po, procesi i vlerësimit ka një sistem pikëzimi i cili gjendet i detajuar në Udhëzuesin për aplikimet në grantet e Iniciativës dhe Partneritetit (Kapitulli: **Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve - ii.Vlerësimi Cilësor/Përmbajtësor i Aplikimit të Plotë**). Nëse aplikimi juaj, referuar sistemit të vlerësimit grumbullon një numër më të lartë pikësh për pjesën përmbajtësore në raport me elementin e eksperiencës e kombinuar edhe me vlerësimin e elementeve të tjerë atëherë, po, propozimi juaj mund të shpallet fitues.

Pyetje

Me shumën e parashikuar për investime (25%), a mund të blihen aparatura për matjen e parametrave të ndryshëm mjedisor ose kamera për të pasqyruar aktivitetin e organizatës gjatë implementimit të projektit?

Përgjigje

Po, mund të kryhen investime për blerjen e aparaturave për matjen e parametrave mjedisore si ndotja e ajrit, ndotja akustike apo investime për rehabilitimin e një zone pyjore të degraduar nëpërmjet mbjelljes së pemëve etj.

Jo, nuk lejohet blerja e kamerave, aparateve fotografike të cilat nuk shërbejnë për përmbushjen e objektivit të monitorimit të elementëve mjedisor. Në këtë rast, inkurajohen aplikantët të bashkëpunojnë me media, organizata, entitete të cilat i kanë këto pajisje.

Pyetje

Sa është buxheti total për projektet e Iniciativës dhe Partneritetit?

Përgjigje

Shuma në dispozicion për grantet e Iniciativës është 200.000€, ndërsa për grantet e Partneritetit do të jetë po 200.000€ për një total prej 400.000€ në dispozicion të OSHC Mjedisore. Ndarja në parim do të ishte 5 projekte fituese për rajon për grantet e Iniciativës dhe 6-7 projekte fituese për grantet e Partneritetit. Megjithatë shpërndarja gjeografike e projekt propozimeve fituese mund të ndryshojë në raport me cilësinë e projekt-propozimeve të ardhura për çdo rajon.

Pyetje

A mund të aplikojë një individ apo organizatë në grantet e Iniciativës dhe partneritetit për të investuar në iniciativa private?

Përgjigje

Jo, ju nuk mund të përfitoni grante në kuadër të projektit Green-AL për të kryer investime në iniciativa private.

Pyetje

A mund të përdoret buxheti i parashikuar për investime për të ngritur një platformë (soft) i cili mund të popullohet me të dhëna të gjeneruara gjatë aplikimit të projektit?

Përgjigje

Në parim ngritja e një platforme digjitale mund të quhet i pranueshëm nga projekti nëse arrihet të shpjegohet dhe ndërlidhet mirë me aktivitetet e tjera të projektit dhe kauzës mjedisore që kërkon të ngrëjë. Megjithatë do të ishte e vështirë të matej impakti që kjo platformë digjitale do të kishte në adresimin e problematikës apo edhe vazhdueshmërisë përsa i përket mirëmbajtjes dhe popullimit me të dhëna të kësaj platforme.

Pyetje

A mund të shtojë qeliza tek Aneksi 1 (forma e aplikimit) tek Kapitulli 2: Informacione të përgjithshme për Aplikantin dhe Partnerin (nëse ka)?

Përgjigje

Po, mund të shtohen qeliza vetëm për aplikantët tek grantet e Partneritetit për të listuar bashkë-aplikantët.

Pyetje

A mund të krijojnë partneritet aplikuesit tek grantet e Iniciativës?

Përgjigje

Do të kishte interes që në këto grante të ngriheshin partneritete me komunitetin, por nëse aplikuesi siguron një marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku citohet se përfaqësues të NJVV-ve mbështesin këtë projekt, është e lejuar. Kujdes, në grantet e Iniciativës NJVV nuk duhet të përfshihen si partner as në aplikimin narrativ as në atë financiar.

Pyetje

A mund të përfshihen në partneritet grupe apo organizata informale?

Përgjigje

Organizata udhëheqëse duhet të plotësojë të gjitha kushtet administrative, personat apo grupimet e tjera partnere mund të jenë dhe informale, me ose pa eksperiencë varësisht tematikës së përzgjedhur lokale apo rajonale. Organizatat që kanë minimalisht 1 vit eksperiencë ftohen të aplikojnë me apo pa partnerë të tjerë por do të punojnë ngushtësisht me komunitetet apo me zonën ku ato janë themeluar/operojnë. Për Grantet e Partneritetit, jemi të hapur që të bëhen partneritet me komunitetet, aktorë, nisma apo struktura që mbështesin një kauzë të caktuar. Partneritetet e ngritura do të jenë 6-7 në Shqipëri dhe sugjerohet që këto të kenë një skeptër të gjerë që përfshijnë mediat, institucionet akademike, autoritete publike & private.

Pyetje

Nëse përfshijmë si partner 2 shkolla të ndryshme të cilat janë pjesë e ZVA-ve, a llogariten si dy partnerë apo si një partner i vetëm?

Përgjigje

Nëse do të lidhet partneritet me 2 shkolla, atëherë shkollat konsiderohen si 2 partnerë të ndryshëm. Nëse partneriteti do të jetë me ZVA si institucion, atëherë do të konsiderohet 1 partner.

Pyetje

Tematika e ngritur nga një thirrje do të jetë **vetëm** një gërshetim i fushave të prezantuara si prioritare gjatë thirrjes së granteve? A është kriter penalizues një tematikë e jashtme?

Përgjigje

Jo, nuk është kriter penalizues; përkundrazi do të ishte me interes të dilej jashtë kornizave të përmendura në prezantim. Projektet potenciale janë indikative për të dhënë udhëzim/shtysë për të aplikuar për projekt-propozime.

Pyetje

A mundet që një organizatë që operon në Tiranë të implementojë projektin në rajonet e tjera?

Përgjigje

Si për grantet e Iniciativës dhe për të Partneritetit, do të ishte ideale që ato organizata që kanë qendrën e themelimit dhe operimit në Tiranë, të mund të operojnë në rajonin e paracaktuar nga projekti. Do të ishte mirë që kjo organizatë të operonte brenda bashkisë apo qarkut Tiranë, por gjithsesi ajo nuk do të penalizohet nëse do të operojnë në qarkun e Durrësit, Elbasanit apo Fierit.

Pyetje

Mund të kemi pushtet vendor në rolin e partnerit kryesor?

Përgjigje

Siç është përmendur dhe në udhëzues, pushteti vendor mund të jetë partner tek grantet e partneritetit por në asnjë mënyrë të jenë partner lider. Mund të jenë mbështetës, por nuk do të kenë buxhet në dispozicion.

Pyetje

A mund të jenë partnerë dy organizata mjedisore dhe një partner tjetër?

Përgjigje

Në këtë rast, patjetër që po. Në udhëzues është shprehur qartë që në grantet e Partneritetit do të jenë 4 partnerë (1 udhëheqës e 3 partnerë). Kombinimet mund të jenë të larmishme; mund të jenë vetëm organizata të shoqërisë civile dhe organizata lider mund të jetë OSHC ndërkohë që partnerët mund të jenë institucione akademike, media, aktorë të tjerë por konsorciumi duhet t'i përgjigjet nga ana logjike dhe logjistike temës apo subjektit mbi ku do të aplikohet.

Pyetje

A mund të aplikohet për projekt me fokus në hapësira rurale?

Përgjigje

Patjetër që po, madje inkurajohet që të aplikoni në Grantet e Iniciativës dhe të Partneritetit, nëse përmbushni të gjitha kriteret administrative.

Pyetje

Nëse organizata operon prej më pak se një vit, a është kriter përjashtues nga aplikimi në grantin e Iniciativës?

Përgjigje

Jo, nuk mund të aplikohet për Grant Initiative pasi është një nga kushtet bazë administrative përvoja minimalisht 1 vjeçare.

Pyetje

A mundet që një organizatë të aplikojë edhe në një grant Initiative dhe në Grante të Partneritetit (jo si lider në këtë rast)?

Përgjigje

Po, nëse plotësoni të gjitha kushtet administrative mund të aplikoni për grante të Iniciativës dhe si partner në grantet e Partneritetit.

Pyetje

Për sa i përket shkëmbimim të përvojave në kuadër të grantit të Partneritetit, aktiviteti do të mbahet në Shqipëri dhe të ftohen fqinjët, apo në vende të tjera të rajonit?

Përgjigje

Në varësi të logjikës së ngritur nga projekti; nëse mendohet se ne si vend kemi një eksperiencë të mirë për të ndarë me fqinjët, do të ndodhë në Shqipëri. Në të kundërt, nëse vlerësohet se iniciativa është më e vlefshme nëse shkohet në një vend tjetër të rajonit, atëherë do të ndodhë jashtë Shqipërisë.

Pyetje

Kur do të organizohen takimet informuese dhe udhëzuese në nivel qarku? Do të jenë online apo takime fizike në ambiente të mbyllura?

Përgjigje

Pas përfundimit të sesionit të informimit, do të ndahen me organizatat kontaktet e koordinatorëve rajonalë përgjegjës për të adresuar pyetjet që mund të jenë të natyrës përmbajtësore, teknike apo administrative për të siguruar që procesi do të jetë më i decentralizuar. Për sa i takon takimeve të dedikuara, do të kemi 2 të tilla të kombinuara me trajnime, përkatësisht me datë **25 Gusht 2021** dhe **3 Shtator 2021** për çdo rajon (online dhe fizikisht). Takimi i datës **25 Gusht 2021** do të ketë në fokus shkrimin e projekt-propozimit, qoftë parë nga aspekti si është i ndërtuar formati i projektit Green-AL, por edhe si një trajnim se si mund t'i qasemi në të ardhmen shkrimin të një projekt-propozimi. Ndërkohë, trajnimi i datës **3 Shtator 2021**, për të cilin do të ndiqet e njëjta logjikë (online dhe fizikisht), konsiston në hartimin dhe materializimin buxhetimin e projekt-propozimit, por për të kuptuar dhe më tutje se si ngrihet një buxhet, varësisht donatorëve.

Pyetje

Nëse një organizatë së fundmi ka përfunduar një projekt mbi bujqësinë organike duke patur në fokus mjedisin, a mund të aplikojnë?

Përgjigje

Nëse organizata nuk ka fokus në mjedis, atëherë nuk mund të bëhet pjesë e propozimit, por megjithatë mund të përfshihet në partneritet me një organizatë tjetër me fokus mjedisin.

Pyetje

Cilët janë organizatat/institucionet e përfaqësuara në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve?

Përgjigje

Komisioni i Vlerësimit do të përbëhet nga përfaqësues të organizatave të cilat formojnë konsorciumin e ngritur në kuadër të këtij projekti, respektivisht: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, CISP - Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli, COSV - Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, VIS - Volontario Internazionale per lo Sviluppo. Komisioni do të përbëhet nga 5 persona.

Pyetje

A do të ketë përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në këtij Komision?

Përgjigje

Jo, nuk do të ketë përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Pyetje

A është i domosdoshëm pjesëmarrja si partner e një aktori/njësie nga qeverisja vendore në modulin e Iniciativës e Partneritetit?

Përgjigje

Jo, në asnjë nga skemat e granteve nuk është e detyrueshme të lidhet një partneritet me NJVV. Përbërja e partneritetit në GP është lënë e lirë të krijohet në varësi të problematikës që kërkon të adresojë partneriteti. Kujdes! Grantet e Iniciativës janë parashikuar të implementohen nga një organizatë e cila mund të bashkëpunojë me komunitetin e zonës në të cilin zbaton projektin.

Pyetje

Dëshirojmë të marrim pjesë në sesionin e Inkubimit të shkrimit të projekteve dhe atë të Menaxhimit Financiar respektivisht në datat 25 gusht dhe 3 shtator 2021. Si dhe kur mund të njoftohemi për pjesëmarrjen në to? Do jenë takime fizike apo takime online?

Përgjigje

Faleminderit për interesin, jeni të mirëpritur. Takimet do të jenë fizike, por në të njëjtën kohë do të kryhen edhe on line për ata persona/org. të cilët nuk mund të paraqiten fizikisht. Përsa i përket vendit e modaliteteve të tjera, ju lutem ndiqni faqen Web të Co-PLAN (<http://www.co-plan.org/en/green-al-fuqizimi-i-organizatave-te-shoqerise-civile-per-mbrojtjen-e-mjedisit-ne-shqiperi/>) si dhe në rrjetet sociale FB dhe IG. Gjithashtu ne do të dërgojmë emaile për të gjithë organizatat të cilat janë pjesë e bazës sonë të të dhënave dhe kanë qenë prezente në takimet informues.

Pyetje dhe përgjigje mbi komponentin financiar

Pyetje

Në formatin e buxhetit, me paga i referoheni kontaktës së punës apo edhe kontratave të shërbimit?

A mund të konsiderohet e pranueshme kontrata e shërbimit?

Përgjigje

Po, i referohemi pagës me kontratë pune.

Po, kontrata e shërbimit konsiderohet por nuk duhet të jenë në zërin e buxhetit të pagave.

Pyetje

Kostot e transportit do të llogariten me kilometra, dhe dietat për vaktet a do të jenë të taksueshme?

Përgjigje

Transporti mund të llogaritet me kilometra, një shifër/mënyrë se si mund të llogaritet transporti është 0.22€ për km. Përsa i përket ditave, ato dieta të cilat do ti jepën stafit të brendshëm të organizatës nuk janë të

taksueshme ndërsa dietat që do ti jepen punonjësve të cilët nuk janë pjesë e organizatës tuaj, atëherë, ky shpenzim do të konsiderohet si honorar dhe duhet të paguhet tatimi në burim.

Pyetje

A ka një raport për vlerën e kostove të parashikuara për aktivitetet?

Nuk ka një raport të përcaktuar, por në procesin e vlerësimit do të shihet se si këto kosto janë alokuar në aktivitete specifike dhe se si këto kosto shërbejnë për të adresuar objektivin e projekt propozimit apo ndërhyrjes të propozuar nga aplikanti.

Pyetje

A ka çmime referencë në raport me kostot e parashikuara për shpenzime apo blerje të ndryshme në kuadër të projektit.

Përgjigje

Jo, nuk ka, por kostot duhet të jenë reale. Procesi i vlerësimit të komponentit teknik dhe financiar do të jenë subjekt i vlerësimit të Komisionit të Vlerësimeve dhe patjetër nëse do të përballen me kosto të cilat Komisioni i vlerëson të fryra apo jo reale atëherë do të jenë një element penalizues për projekt propozimin tuaj.

Pyetje

Si duhet të qëndrojnë shpenzimet administrative në raport me buxhtin total të kërkuar?

Përgjigje

Ndarja e zërave buxhetor ndryshon në varësi të peshës specifike që aplikanti kërkon t'i japë aktiviteteve të ndryshme për të përmbushur indikatorët e parashikuar në projekt propozim.

Nëse organizata aplikuese ka në stafin e saj një shumëllojshmëri ekspertësh atëherë edhe zëri i pagave në buxhet do të jetë më i lartë, nga ana tjetër nëse organizata do të kontraktojë ekspert të jashtëm atëherë zëri shërbimeve që do të blihen (kapitulli 4 tek Aneksi 2 Forma e Buxhetit) do të jetë më i lartë. Në të gjitha rastet ndarja e zërave të buxhetit do të jetë subjekt i vlerësimit nga ana e Komitetit Vlerësues.

Pyetje

A ka një tavan dhe një dysheme për kostot e stafit?

Përgjigje

Nuk ka një tavan për sa i përket kostos ndërsa për kostot dysheme duhet zbatuar Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, ku duhet të aplikohet minimalisht paga minimale referuar Ligjit nr 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/844/mbi-percaktimin-e-pages-minimale-ne-shkalle-vendi>).

Pyetje

Nëse gjatë zbatimit, lind nevoja për lëvizje të buxhetit brenda zërave të projektit, a do të lejohet?

Përgjigje

Projektet përgjithësisht janë të shtrira në një kohë relativisht të shkurtër (5-15 muaj). Për projektet të cilat kanë shtrirje minimale, do të ishte e vështirë për të bërë rialokime sepse në 5 muaj nuk do të ndryshojë asgjë në planifikimin e organizatës, përveç rasteve madhore të cilat mund të merren në konsideratë. Në kontratën në të cilin do të lidhen me grantin, do të jenë të përcaktuara këto kushte. Mund të ketë një tavan i cili nuk shkon më shumë se sa 10%, megjithatë kjo është për t'u diskutuar me aplikantët fitues.

Pyetje

Në formatin e buxhetit të paraqitur, nuk është ndarja e buxheteve për partnerët. Si do të pasqyrohet kjo?

Përgjigje

Buxheti do të jetë integral dhe koordinatori do të përgjigjet për buxhetin dhe për të raportuar dokumentet financiare në Co-PLAN. Rrjedhimisht, në shënimet e kolonës së fundit "Justifikime" ju mund të vendosni cili është koordinatori përgjegjës, por nuk është e domosdoshme. Se si do të ndahen veprimtaritë brenda partneritetit, duhet të shkruhet në projekt-propozim por jo në buxhet.

Pyetje

Tek zëri i ekspertizës a duhet të jetë patjetër ekspert i jashtëm apo mund të jetë dhe një ekspert brenda organizatës?

Përgjigje

Nëse individi është i kontraktuar me kontratë pune, atëherë do të kalojë në buxhetin e pagave; Nëse individi do të jetë i kontraktuar me kontratë shërbimi, atëherë do të jetë tek zëri i ekspertizës.

**Projekti Green-AL "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat CISP (Comitato Internazionale per Sviluppo dei Popoli), VIS Albania (Volontario Internazionale per lo Sviluppo) & COSV (Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario).*